

VENDIM
Nr.36.datë 1.8.2005

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË KURUM ENERGY SHA PËR LICENCËN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR DHE IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1 germa ç dhe dh, nenit 15 pika 1 dhe nenit 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11, bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.8.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Kurum Energy sh.a. për licencën e furnizuesit të kualifikuar dhe të importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Vazhdimin e mëtejshëm të procedurave për shqyrtimin e kërkesës Së shoqërisë Kurum Energy sh.a.
 2. Ngarkohet Departamenti i Licencave & Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore & Marrëdhënieve me Publikun për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema